



## UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës  
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref. nr 0512714 Dt. 23 / 11 / 2021

### THIRRJE PËR PUNË PRAKTIKE PËR DY STUDENTË TË UKZ-së

Bazuar në Rregulloren e Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, për angazhimin e studentëve në punë praktike në administratën e Universitetit, ftohen studentët e UKZ-së që të aplikojnë për punë praktike në UKZ, respektivisht në Zyrën e Prorektorit për Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Puna praktike ka si objektiv që t'ju ofrojë studentëve mundësi që dijen teorike të nxënë gjatë studimeve, ta aplikojnë në praktikë dhe njëkohësisht të fitojnë përvojë të punës praktike, me qëllim të promovimit, aftësimin dhe avancimin profesional të studentëve dhe të posa diplomuarve. Puna e studentëve ndërlidhet me bashkëpunimin ndërkombëtar të UKZ-së, projektet ndërkombëtare – ERASMUS+, punë që ndërlidhen me teknologji informative, si mirëmbajtja (postimi) e Web të Projektit QUADIC, mirëmbajtja (postimet) e faqeve të rrjeteve sociale të projekteve të UKZ-së, përcjellja dhe postimi në faqen e UKZ-së që ka të bëjë me bashkëpunimin ndërkombëtar, hulumtimi i mundësive të reja të bashkëpunimit me universitete nga rajoni, BE-ja dhe SHBA-ja e më gjerë, përgaditja e dokumentacionit për anëtarësime në rrjete të ndryshme ndërkombëtare që ndërlidhen me arsimin e lartë.

Për punë praktike do të angazhohen një studentë nga Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe një studentë nga Fakultetet e tjera, të cilët do të kenë plotësuar më së miri kriteret e mëposhtme:

#### Kriteret për përzgjedhjen e studentëve për punë praktike janë:

- Nota mesatare;
- Njohja e gjuhës angleze – Niveli B1 ose C2;
- Njohja dhe përdorimit të teknologjisë informative;
- Njohja e aktivitetit në shërbim të komunitetit studentor e akademik;
- Studentët që aplikojnë për të kryer punë praktike duhet të jenë studentë të vitit të fundit të studimeve (për nivelin bachelor) ose të jenë të regjistruar në studimet master;
- Kandidatët nuk duhet të kenë vite të studimit të përsëritura.

Përzgjedhjen e studentëve për punë praktike do ta bëjë komisioni profesional në përbërje prej:

1. Prof. Asoc. Dr. Dukagjin Leka, Kryetar i Komisionit
2. Prof. Ass. Dr. Selim Daku, Anëtar
3. Znj. Minire Haziri – Rexhepi, Anëtare

### **Rregullimi i punës praktike:**

- Studentët e përzgjedhur për punë praktike duhet të nënshkruajnë deklaratën etike, si dhe kontratën e angazhimit me Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e tyre;
- Kohëzgjatja e punës praktike është tre muaj (3 muaj), me mundësi të zgjatjes edhe për një kohë më të gjatë, nëse studentët tregohen me cilësi të shkëlqyera në fushat që kërkohet puna e tyre.
- Periudha e angazhimit në punë praktike është me pagesë dhe studentët do të paguhen nga projektet ndërkombëtare – Erasmus+. Pagesa do të jetë 160 bruto minus shpenzimet për tatum në të ardhura dhe 10% për fondin pensional;
- Për suksese në punën praktike, studentët mund të stimulohen edhe me pagesa shtesë nga projektet.
- Studentët me rezultate të shkëlqyera gjatë punës praktike mund të bëhen edhe pjesë e vizitave studimore në kuadër të projekteve ERASMUS+.
- Në fund të periudhës së angazhimit të punës praktike, bëhet vlerësimi i punës së praktikantëve dhe bazuar në vlerësim, lëshohet certifikata për punën praktike;
- Praktikantët e angazhuar iu nënshtrihen Statutit, rregulloreve dhe të gjitha akteve të nxjerra nga Universiteti.

### **Kandidatët me rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë:**

- Një CV;
- Një letër motivim për punë praktike;
- Certifikatën e notave;
- Vërtetimin mbi statusin e studentit Bachelor-Master;
- Kopjen e Letërnjoftimit;
- Dokument që vërteton njohjen e Gjuhës Angleze;

### **Thirrja mbetet e hapur 7 ditë.**

Data për aplikim: 23/11/2021 deri më 30/11/2021 në ora 16:00;


Për përzgjedhjen e kandidatëve më të mirë do të mbahen intervista. Intervista mbahet vetëm për ata kandidatë që sipas dokumenteve të paraqitura futen në listë të ngushtë për tu ftuar për intervistë.

Shpallja e listave do të bëhet në faqen zyrtare të Universitetit;

Dokumentet duhen të dorëzohen në Rektoratin e UKZ-së si dhe në formatin elektronik PDF, në email adresën [info@uni-gjilan.net](mailto:info@uni-gjilan.net)

Kandidatët që nuk pranohen në këtë thirrje për praktikantë kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave që funksionon në kuadër të administratës së Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan.

Inkurajohen që të aplikojnë të gjithë studentët e UKZ-së, pa kurrfarë diskriminimi, respektivisht të gjithë ata të cilët i plotësojnë kriteret e lartcekura.

  
Prof. Asoc. Dr. Dukagjin Leka  
Prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar